

Në bazë të nenit 18 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 20 paragrafi (1) nënparagrafi 10<sup>1</sup> të Ligjit të Shërbimeve Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr. 184/13, 13/14, 44/14, 101/14, 132/14, 142/16, 132/17, 168/18, 248/18 dhe 27/19 dhe „Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut“ nr.42/20 dhe 77/21), dhe në lidhje me nenin 41 paragrafi (6) nga Ligji i njëjtë, neni 15 paragrafi (1) nënparagrafi 3 dhe neni 39 paragrafi (1) nënparagrafi 10 nga Rregullorja për punë e Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Tekst i pastruar) ark.nr.01-3732/1 datë 29.7.2019, duke vepruar sipas Njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, PA1 nr.02-149 datë 4.4.2023, në pajtim me Konkluzionin e Këshillit ark.nr.02-1946/4 datë 4.5.2023, Këshilli i Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele, në seancën e 14-të mbajtur më 3.5.2023 miratoi si vijon:

## VENDIM

1. LEJOHET ndryshim në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, përkatësisht:

- për largim të personit fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën „[REDAKTUAR]“ nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], dhe

- për aderim të personit fizik, [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën „[REDAKTUAR]“ nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR].

2. Detyrohet Shoqëria Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, pas ndryshimit të kryer përcaktuar në pikën 1 të këtij Vendimi, drejtuar Agjencisë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele t'i dorëzon gjendjen aktuale vijuese të dhënë nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

3. Ky vendim hyn në fuqi ditën e miratimit.

## Arsyetim

Shoqëria Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, në pajtim me nenin 41 paragrafi (1) të Ligjit për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (LSHMAAV) dhe Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshimin e strukturës së pronësisë („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.171/14), me Njoftim për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-149 datë 4.4.2023.), e njoftoi Agjencinë për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele (Agjencia) për qëllimin e tij për realizimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup.

Njoftimi i dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë (PA1 nr.02-149 datë 4.4.2023.), nga Shoqëria Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup, është konstatuar se është i plotë dhe i rregullt, respektivisht i përmban të gjitha të dhënat dhe dokumentet e përcaktuara në Rregulloren për formën dhe përmbajtjen e njoftimit për ndryshim të strukturës së pronësisë.

Agjencia, për të hetuar nëse ndryshimet e propozuara në strukturën e pronësisë të Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup do të krijojnë koncentrim të paligjshëm mediatik, respektivisht nëse bien në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) ose 38 të LSHMAAV, nëpërmjet Sistemit të shpërndarjes së internetit nga Regjistri Qendror i Republikës së Maqedonisë së Veriut (RMV), ofroi dokument „Informacion për subjektet që ndërlidhet (personat e autorizuar, organet drejtuese, pronarë në subjekte të tjera) –

<sup>1</sup>Nënparagrafët (8) dhe (9) fshihen, shih: nenin 8 të Ligjit për ndryshimin dhe plotësimin e Ligji për Shërbime Mediatike Audio dhe Audiovizuele („Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë“ nr.248/18).

Gjendja vijuese“, nr.0820-50/150020230091119 datë 4.4.2023., nga e cila rezulton se personi [REDAKTUAR] figuron si pronar dhe drejtues i Shoqërisë për Shërbime DRIM KLINING SHPKNJP Shkup, me veprimtari parësore/kodi kryesor i të ardhurave është 45.20 – Mirëmbajtja dhe riparimi i mjeteve motorike. Ky person juridik nuk paraqitet (figuron) si themelues i Shoqërive Tregtare.

Po ashtu, Agjencia ka kontrolluar edhe në Regjistrin e pronarëve përfitues (të vetëm), i cili udhëhiqet nga Regjistri Qendror i RMV-së, nga ku siguroi dokumentin për „Gjendjen aktuale të personit fizik – pronarit përfitues (të vetëm)“, nr.2007-50/150020230091288 datë 4.4.2023., për [REDAKTUAR], ku u vërtetua se personi në fjalë paraqitet si pronar i vetëm i subjektit juridik të lartpërmendur.

Pas ndryshimit të kryer të strukturës së pronësisë, pronar i vetëm i Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup do të jetë personi fizik [REDAKTUAR], me NVAQ [REDAKTUAR] dhe adresë në rrugën „[REDAKTUAR]“ nr. [REDAKTUAR], [REDAKTUAR], me pjesëmarrje të kapitalit bazë prej 100%.

Duke pasur parasysh se Agjencia ka konstatuar se me realizimin e ndryshimit të strukturës së pronësisë të Shoqërisë Tregtare me veprimtari radio-difuzive TV SHUTEL SHPKNJP Shkup nuk krijohet koncetrim i paligjshëm mediatik në kuptimin e LSHMAAV, përkatësisht se ky ndryshim nuk bie në kundërshtim me ndalesat e neneve 34, 35 paragrafi (2) dhe 38 nga Ligji i njëjtë, pas Njoftimit të dorëzuar për ndryshimin e strukturës së pronësisë PA1 nr.02-149 datë 4.4.2023., Këshilli i Agjencisë miratoi vendim si në dispozitiv.

**Nr.02-149**

**04.05.2023**

**Shkup**

**Agjencia për Shërbime Mediatike**

**Audio dhe Audiovizuale**

**Kryetari i Këshillit,**

**Lazo PETRUSHEVSKI, d.v.**

**Këshillë juridike:** Kundër këtij vendimi transmetuesi, nëse nuk pajtohet, ka të drejtë në afat prej 30 ditësh nga dita e dorëzimit të vendimit të paraqesë padi për ngritje të kontestit administrativ para gjykatës kompetente.